



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANË

NR. AKTI 2775

NR. VENDIMI 2189



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR  
TIRANE

Nr.1631/SP/2775 Rregj.Them.  
Data rregj.08.06.2021/SP/06.07.2021.  
14.07.2021.

NR.2189 VENDIMI  
Data vendimit

VENDIM  
“NE EMER TE REPUBLIKES”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përbërë nga:

**Gjyqtar : Ahmet METALIAJ**

Asistuar nga sekretare gjyqësore **Gentiana Sadiku**, në Tiranë, sot më datë **14.07.2021**, mori në shqyrtim në séancë gjyqësore me dyer te hapura, çështjen penale me **Nr.1631/2775** Rregj. që i përket:

**KËRKUES:**

**Prokuroria pranë Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranë**, përfaqësuar nga Prokurori **Valentin Preçi**.

**IPANDEHUR:**

**Desjan Mingla**, i biri i Ferit dhe Tefta, i dtl. 07.10.1995, lindur në Burrel dhe banues në Tiranë, Rruga: “Muhamet Gjollësja”, Nd.12, H.3, Ap.7, pallati 27, ap.27, me kombesi e shtetesi shqiptare, gjendja familjare beqar, me arsim 9-të vjeçar, i padënuar, hetuar me masë sigurimi “arrest në burg”, i mbrojtur nga Av.Stjuart Leli, identifikuar me Liçencën nr.10852 dhe Nipt M01314033A, “Dhoma Avokatise” Tiranë, me deklaram në seancë.

**AKUZUAR :**

Për kryerjen e veprës penale të të “**Prodhim dhe shitje e narkotikëve**”, parashikuar nga Neni 283/1 të K.Penal.

**KËRKUES:**

**Prokuroria pranë Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranë**, përfaqësuar nga Prokurori **Valentin**

## **Preçi.**

### **P/NËN HETIM:**

**Daniel Mingla**, (i mitur) i biri i Ferit dhe Tefta, i dtl.04.12.2003, lindur në Kavajë dhe banues në Tiranë, Rruga: “Muhamet Gjollësja”, Nd.12, H.3, Ap.7, pallati 27, ap.27, me kombesi e shtetesi shqiptare, me arsim të mesëm, gjendja familjare beqar, me arsim të mesëm në vazhdim pranë gjimnazit “Sinan Tafaj”, i padënuar, hetuar me masë sigurimi “Vendosja e të miturit në mbikqyrje”, parashikuar nga neni 83 i K.D.P.Mitur, në mungesë, mbrojtur nga Av.Stjuart Leli, identifikuar me Liçencën nr.10852 dhe Nipt M01314033A, “Dhoma Avokatisë” Tiranë, me deklaram në séance, asistuar nga psikologja Olta Jaçellari me të dhënat profesionale me Nr.261 Liçense, dhe nr.Nipti L81428012M me urdhër për caktimin e psikologut.

### **ME OBJEKT:**

Pushimin e hetimeve në ngarkim të miturit në konflikt me ligjin **Daniel Mingla**, për veprën penale të “**Prodhim dhe shitje e narkotikëve**”, të parashikuar nga neni 283/2 të Kodit Penal., në lidhje me procedimin penal Nr.1612/2021.

### **BAZA LIGJORE:**

Nenet 283/ të K.Penal, 328/1 germa “b” dhe 329/a të K.Pr.P.

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, të zhvilluar në prani të prokurorit, avokatit e të pandehurit **Desjan Mingla**, e personit nën hetim (të miturit në konflikt me ligjin) **Daniel Mingla** gjykata pasi administroi aktet;

Degjoi prokurorin, e cila kerkoi:

- Pranimin e kërkesave.

Degjoi mbrojtjen e të pandehurit **Desjan Mingla**, e të personin nën hetim (miturin në konflikt me ligjin) **Daniel Mingla**, avokatin përfundimisht: Jemi dakort me kërkesën e organit të akuzës, kërkojmë të procedohet me gjykim të shkurtuar.

I pandehuri **Desjan Mingla** përfundimisht:

- Jam dakort me avoktin, dhe kërkoj të procedohet me gjykim të shkurtuar

I miturit në konflikt me ligjin **Daniel Mingla** në mungesë.

si dhe pasi shqyrtoi në tërësi rrethanat e çështjes;

### **VËREN SE :**

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, mbi bazen e materialit referues të dërguar nga K.Rajonal të Policisë Rrugore Tiranë, dërguar me shkresën me nr.4844/k.Prot. datë 03.03.2021 ka regjistruar me datë 03.03.2021 procedimin penal nr.1612/2021, për kryerjen e vepres penale të “**Prodhim dhe shitje e narkotikëve**”, të parashikuar nga neni 283/2 i K.Penal, në ngarkim të

shtetasëve **Desjan Mingla** dhe **Daniel Mingla**.

Gjykata, bazuar ne nenet 74-76 të K.Pr.Penale, konstaton se është kompetente si në pikepamjen lendore ashtu dhe ne ate tokësore për të shqyrtuar çështjen gjyqesore penale të paraqitur nga Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Tirane, prokurori e cila është kompetente dhe pergjegjese për ndjekjen e këtij procedimi penal, të regjistruar per vepren penale të “Prodhim dhe shitje e narkotikëve”, të parashikuar nga neni 283/2 të K. Penal.

Nga ana e palëve në proces nuk pati pretendime lidhur me kompetencën apo juridiksionin e Gjykatës si edhe vetë Gjykata nuk konstatoi kryesisht shkaqe papajtueshmërie për gjykimin e kësaj çështjeje. Për shkak të masës së dënimit të parashikuar posaçërisht nga dispozita e ligjit material penal, neni 283/1 të Kodit Penal, për të cilën akuzohet e pandehuri **Desjan Mingla** në kuptim të nenit 13/3 (ndryshuar me ligjin nr.35/2017) të K.Pr.Penale, gjykimi i kësaj çështjeje u zhvillua nga gjyqtar i vetëm.

Nga aktet e hetimeve paraprake te procedimit penal Nr.1612/2021, rezultojnë të provuara faktet e rrethanat qe vijojnë se;

Me date 02.03.2021, rreth ores 18:40, ne rrugen "Kongresi Tiranes", Tiranë, nga ana e punonjesve të policise të Komisarariatit te Policise Nr.3 Tiranë, është ushtruar kontroll në lokalitn që kishte me qera Desjan Mingla, ku gjatë kontrollit të lokalit në një triko të varur në gozhde, në afersi të banakut u gjet një sasi lende narkotike e llojit “kokaine” e cila ishte ndare në doza, të cilat pasi u nurneruan rezultuan 49 qese plastike me ngjyre si të bardhe të mbyllura me djegie brenda të cilave kishte material pluhur me ngjyre të bardhe të dyshuar si lendë narkotike Kokaine dhe një qese tjetër pak me e madhe me ngjyre si të bardhe të mbyllura me djegie brenda të cilave kishte material pluhur me ngjyre te bardhe të dyshuar si lende narkotike kokaine dhe një peshore elektronike me mbetje pluhur të bardhe të dyshuar si lendes narkotike Kokaine.

Në momentin që kane hyrë punonjesit e policise shtetasi Desjan Mingla ka tentuar të fshehe lenden narkotike. Kamarjeri ne lokal ishte vellai tjetër i mituri Daniel Mingla. Peshorja elektronike u fut në qesen e provave me Nr.UNIK. A20004038. U bë sekuestrimi lendës të dyshuar narkotike të llojit kokaine, u bë peshimi i saj dhe rezultoi me peshe të pergjithshme me amballazh **32.6** (tridhjetë e dy pike gjashtë) gram, e cila pas peshimit u fut në qesen e provave me Nr.UNIK. A20004037.

Eshtë bërë qyryje e vendit të ngjarjes në ambientin bar kafe "Bonsai" ku u gjend sasia e dyshuar lendë narkotike kokaine si dhe kontrolli i vendeve në kete ambient dhe kontrolli i baneses ku banojne shtetasit Desjan dhe Daniel Mingla. I është marrë kampioni i urines shtetasve Desjan Mingla dhe Daniel Mingla dhe do te dergohet për ekspertim toksikologjik prane IML.U kryen vendimet e ekspertimit kimik dhe toksikologjik lidhur me rastin si dhe janë administruar raporti i sherbimit si dhe kapja ne flagrante. Eshte bërë vendimi per kryerjen e ekspertimit daktiloskopik vleresues për qeset me lende të dyshuar narkotike te llojit kokaine të gjetur në lokalitn e shtetasve Daniel Mingla dhe Desjan Mingla.

Nga akti i ekspertimit daktiloskopik vleresues ka rrezultuar se:

- nuk janë perftuar gjurme të vlefshme per identifikim.

Sipas Aktit te Ekspertimit Toksikologjiko-Ligjor nr.609, date 05.03.2021 ka rezultuar se:

- ne mostren e urines të shtetasit te mitur në konflikte me ligjin *Daniel Mingla* marre tek

diten e ngjarjes, u zbulua prania e produkteve të metabolizmit të kokainës (benzoilekgonine) në orgazimit e njeriut.

Sipas Aktit të Ekspertimit Toksikologjiko-Ligjor nr.610, date 05.03.2021 ka rezultuar se:

- ne mostren e urines marre tek shtetasi *Desjan Mingla* ditën e ngjarjes, u zbulua prania e produkteve të metabolizmit të kokainës (benzoilekgonine) në orgazimit e njeriut

Nga Akti e Ekspertimit Kimik Lende nr.4007, date 30.04.2021, në ngarkim të shtetasit Desjan Mingla ka rezultuar se :

1. Analiza me GC/ms me mbetjet në peshore objekt ekspertimi, tregoi për mbetje të kokainës.
2. pesha në mbetjet nuk mund të realizohet.

Nga Akti i Ekspertimit Kimik Lende , nr.4005 , date 30.04.2021, në ngarkim të shtetasit Desjan Mingla ka rezultuar se ;

- Analiza me GC/ms materialet ,objekt ekspertimi, tregoi për praninë e kokainës.
- Pesha e materialeve objekt ekspertimi në total është **29.798** gram.

Eshtë pyetur me cilënne e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime shtetasi *Desjan Mingla* ka shpjeguar se:

- është prej disa vitesh përdorues i rregullt i lëndës narkotike e llojit Kokaine.

Lidhur me ngjarjen e datës 02.03.2021, ku është kapur në flagrance me sasinë prej 32.6 gr kokaine, ka shpjeguar se:

- ajo është e tija dhe e kishte blerë tek një person në Kamez, në vlerën e 500 leke të reja, për përdorim personal, dhe nuk e ka blerë për ta tregtuar, ku e atë person e ka takuar rastesisht, dhe nuk njihet nga ana e tij me parë. Pas kësaj është kthyer me autobus, dhe duke patur frikë se mos ndalohej rrugës nga ndonjë patrull policie, ka vendosur që ta fsheh lëndën narkotike në lokal. Pas dy orësh ka shkuar policia për kontroll ku dhe është gjetur lenda narkotike Kokaine. Asnjë person tjetër nuk ka dijeni për lëndën narkotike, as dhe vëllai tij, Daniel Mingla, pasi ky i fundit vazhdon të shkollon në mesëm, dhe vinte jo shpesh ku ndihmonte në pastrimin e lokalit, sikurse ishte dhe ditën e ngjarjes. Vëllai tij Daniel Mingla nuk është përdorues i asnjë lende narkotike.

Eshtë pyetur me cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime shtetasi i mitur në konflikt me ligjin *Daniel Mingla* ka shpjeguar se:

- ai shkon tek lokali i marre me qera nga familja, pasi ndihmon nënë e tij me punë në banak apo dhe pune të tjera. Nuk është i punësuar aty, pasi vazhdon të shkollon në vitin 2-të në gjimnazin "Sinan Tafaj", por kur ka mundësi, shkon 1 apo 2 orë në ditë. Kishte shkuar para një ore (me përpara para se të kontrollonte policia në lokal) për ta ndihmuar vëllain në lokal, pastrim lokal. Po ashtu ky shtetas deklaron se ai nuk ka patur dijeni për lëndën narkotike të gjetur në lokal ditën që është kontrolluar nga policia, dhe që poseduesi i saj është vëllai tij Desjan Mingla. Për këtë arsye nuk e pranon akuzën që është ndaj tij. Po ashtu ka shpjeguar se ka përdorur me rastësi lende narkotike të llojit "cannabis" por asnjë herë nuk ka përdorur lëndën narkotike "Kokaine".

Lidhur me faktin se nga akti ekspertimit toksikologjik nr.609, date 05.03.2021 ka rezultuar se në mostren e urines marre tek ditën e ngjarjes, u zbulua prania e produkteve të metabolizmit të kokainës (benzoilekgonine) në orgazimit e njeriut, shtetasi i mitur në konflikt me ligjin Daniel Mingla deklaron se:

- nuk është e vertetë për çfarë ka konkluduar akti ekspertimit toksikologjik, pasi ai asnjë

here nuk ka perdorur lende narkotike të llojit kokaine.

Pyetur me cilesine e personit qe tregon rrethana objekt hetimi, shtetasit *Nikolin Mardodaj*, me detyre agjent i policise kriminale Komisariatin e Policise Nr.3 Tirane ( lidhur ma kapjen ne flagrance te shtetasve Desjan Mingla dhe Daniel Mingla, ne date 02.03.2021, rreth ores 18:40, gjate kontrollit ne lokalin "Besoj" ndodhur ne rrugen "Kongresi i Tiranes) ka shpjeguar se:

- ne lokalin ku ushtronte aktivitetin shtetasi Desjan Mingla është ushtruar kontroll në kuader të goditjes të veprave mbi perdorimin dhe shitjen e narkotikeve. Konkretisht gjatë kontrollit, në afersi të banakut në një triko të vjeter e varur në mur, në xhepin e majtë e saj u brenda një qese plastike e tejdukshme me një sasi pluhri me ngjyre të bardhe dhe një peshore në tavoline, ku afer saj u gjet një qese me pluhur te dyshuar kokaine. Ku në këtë qese ishin mbeshtjell disa doza të dyshuar si "kokaine" dhe në qesen tjeter ishte nje sasi pluhur e dyshuar "kokaine". Gjate kontrollit ne pjesen e siperme te frigoriferit ishte një qese bardhe plastike në disa doza, e dyshuar "Kokaine", gjithsej tre qese.

Në lokal ishte vellai tij Daniel Mingla, me detyre kamarier, dhe pas kontrollit te ambjentit ne kete lokal, u afruar dhe vellai tjeter Ani Mingla. Shtetasit Nikolin Mardodaj ka shpjeguar se në momentin e hyrjes policisë në lokal, shtetasi Desjan Mingla tentoi që të fshinte qeset dhe peshoren, ku ne qese ishte futur lenda e dyshuar "Kokainë", ku ky shtetas tentoi ta fuste në xhepi i trikos. Pas ketyre veprimeve, keta shtetas u shoqeruan per ne Drejtorine Vendore të Policise Tirane, për veprime të metejshme.

Nga ana e policise u mbajte proces-verbali i kapjes ne flagrance si dhe raporti i sherbimit. Pyetur me cilesine e personit që tregon rrethana objekt hetimi, shtetasit *Saimir Ismaili* (agjent i policise kriminale ne Komisariatin nr.3 te Polcise Tirane, ka shpjeguar sa siper (faktin e kapjes ne flagranc te ketyre dy shtetasve).

Sa me sipër në keto kushte, nga hetimi nuk rezulton e provuar se i mituri ne konflikt me ligjin **Daniel Minga të ketë** bashkepunuar ne kryerjen e vepres penale ne asnje nga format e bashkpunimit, me vllain e tij shtetasin **Desjan Mingla**, ku ky i fundit rrezulton e provuar se ka mbajtur me qellim shitjen të sasise së lendes narkotike të llojit kokaine të gjetur nga policia në nje triko të varur në gozhde, në lokalin qe kishte me qera **Desjan Mingla** duke konsumuar keshtu elementet e vepres penale të "Prodhimit dhe shitjes së narkotikeve", parashikuar neni 283/1 i Kodi Penal.

Për këtë arsye, hetimet e filluara ndaj te miturit në konflikt me ligjin *Daniel Minga* i hetuar për vepren penale të "*Prodhimit dhe shitjes së narkotikeve*", parashikuar nga neni 283/2 i K.Penal duhet të pushohen.

Në keto kushte rezulton plotesisht e provuar se pandehuri **Desjan Mingla** ka konsumuar elementet e vepres penale "Prodhimit dhe shitjes së narkotikeve" parashikuar neni 283/1 i Kodit Penal.

Per te provuar faktet e mesiperme, ne lidhje me akuzen qe i atribuohet te pandehurit, nga ana e organit te akuzes jane paraqitur ne cilesine e proves:

1. Informacion per referimin e vepres penale.
2. Raport Sherbimi i dates 02.03.2021.
3. Proces-verbal i kapjes ne flagrance i dates 02.03.2021.
4. Proces-verbal mbi kontrollin e vendeve, date 02.03.2021.

5. Proces-verbal i keqyrjes se vendit te ngjarjes, date 02.03.2021.
6. Proces-verbal mbi kontrollin e vendeve, date 02.03.2021.
7. Proces-verbal mbi arrestimin ne flagrance Desjan Mingla, date 02.03.2021.
8. Proces-verbal i kontrollit personal Desjan Mingla.
9. Proces-verbal mbi arrestimin ne flagrance Daniel Mingla, date 02.03.2021.
10. Proces-verbal i kontrollit personal Daniel Mingla.
11. Procesverbal marrjen e te dhenave nga personi ndaj te cilit zhvillohen hetime.
12. Proces-verbal per kqyrjen dhe marrjen e proves material.
13. Proces-verbal i peshimit te provave materiale (lende).
14. Proces-verbal per sekuestrimin e sendeve (lende, peshore).
15. Proces-verbal per kryerjen e ekspertimit daktiloskopik vleresues.
16. Proces-verbal per kryerjen e ekspertimit kimik te lendes,
17. Proces-verbal per kryerjen e ekspertimit kimik te lendes (peshore).
18. Proces-verbal per marrjen e mostres per ekspertim Desjan Mingla.
19. Proces-verbal per kryerjen e ekspertimit toksikologjik Desjan Mingla.
20. Proces-verbal per marrjen e mostres per ekspertim Daniel Mingla,
21. Aktit te Ekspertimit Toksikologjiko-Ligjor nr.609, date 05.03.2021.
22. Aktit te Ekspertimit Toksikologjiko-Ligjor nr.610, date 05.03.2021.
23. Akti i ekspertimit vleresues te proves materiale nr.2415 date 12.03.2021.
24. Akti e Ekspertimit Kimik Lende nr.4007, date 30.04.2021.
25. Si dhe në tërësi fashikullin hetimor **nr.1612/2021**.

Gjatë shqyrtimit gjyqesor të kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqesor Tiranë për dërgimin për gjykim të procedimit penal në ngarkim të të pandehurit **Desjan Mingla**, Gjykata konstatoi se, nga ana mbrojtjes e të pandehurit **Desjan Mingla**, u paraqit kërkesa, për gjykim e kësaj çështje me proçedurën e **gjykimit të shkurtuar**.

Në lidhje me kërkesën për gjykim të shkurtuar parashtruar nga i pandehuri, Gjykata thekson se në interpretimin literal dhe logjik të nenit 403 të Kodit të Procedurës Penale, ku parashikohet se:

- “I pandehuri ose përfaqësuesi i tij i posaçëm mund të kërkojnë që çështja të përfundohet derisa të mos ketë filluar shqyrtimi gjyqësor” në harmoni edhe me parimet e përgjithshme mbi të cilat udhëhiqet i gjithë procedimi penal ndaj të pandehurit”

Nga ana e saj, Prokurori **Valentin Preçi** kërkoi që çështja të kalonte për gjykim duke ia derguar Gjykates kompetente dhe ishte dakort që të procedohej me gjykim të shkurtuar, ne respekt të nenit 332/dh, pika 1/c e K.Pr.Penale.

Sipas Prokurorit, aktet e hetimeve paraprake janë të plota dhe çështja mund të zgjidhej në gjendjen që janë aktet.

***Sa më sipër Gjykata çmon e vlerëson se bazuar në nenin 332/c të K.Pr.Penale fton palët në konkluzione përfundimtare ku :***

Prokurori përfundimisht kërkoi:

- Deklarimin fajtor te te pandehurit **Desjan Mingla**, për kryerjen e veprës penale te “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga nent 283/1 i K.Penal dhe denimin e tij me **6 (gjashtë)** vjet burgim.
- Aplikimin e nenit 406 të Kodit Pr.Penale, mbi këtë masë dënimi.
- **Pushimin** e hetimeve në ngarkim të miturit në konflikt me ligjin **Daniel Mingla**, për veprën penale të “Prodhim dhe shitje e narkotikëve”, të parashikuar nga neni 283/2 të

Kodit Penal., në lidhje me procedimin penal Nr.1612/2021.

- Shpenzimet procedurale të hetimeve paraprake dhe ato gjyqësore ti ngarkohen të pandehurit.

Mbrojtja e të pandehurit **Desjan Mingla**, avokati përfundimisht kërkoi:

- Deklarimin fajtor të të pandehurit **Desjan Mingla** për kryerjen e veprës penale të “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 të K.Penal dhe denimin e tij me minimumin e parashikuar nga kjo dispozitë.
- Duke mbajtur në konsideratë zbatimin e nenit 406/1 të K.Pr.penale, uljen e dënimit të dhënë dhe në zbatim të nenit 59 të K.Penal, pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim për pjesën e mbetur pa vuajtur të dënimit për të pandehurin **Desjan Mingla**, dhe vënien në provë.

I pandehuri **Desjan Mingla** përfundimisht: Jam dakort me avokatin, unë jam vetëm perdorues, dhe kerkoj meshire.

Gjykata pasi analizoi dhe shqyrtoi aktet e ndodhura në fashikullin e prokurorit, i cili u shndërrua në fashikull gjykimi, krijoi bindjen e saj të bazuar në këto akte dhe në ligj se i pandehuri **Desjan Mingla**, ka konsumuar elementët e figurave të veprës penale të “Prodhim dhe shitje e narkotikeve” parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal.

Përsa i përket kualifikimit ligjor të fakteve të parashtruara më sipër Gjykata vëren se, neni 283/1 i K.Penal, parashikonte se:

**Neni 283/1 i Kodit Penal.**

***Prodhimi dhe shitja e narkotikeve***

*(Ndryshuar paragrafi I dhe III, shtuar paragrafi II  
me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001)*

*Shitja, ofrimi për shtije, dhënia ose marrja në çdo formë, shperndarja, tregtimi, transportimi, dërgimi, dorëzimi, si dhe mbajtja, përveç rastit të perdorimit vetjak dhe në doza të vogla, të substancave narkotike dhe psikotrope, si dhe i farërave të bimeve narkotike, në kundërshtim me ligjin ose në kapërcim të përmbajtjes së tyre, denohet me **burgim nga pesë gjer në dhjetë vjete.***

Në analizë të ekzistencës së elementëve të figurës së veprës penale të “Prodhim dhe shitje e narkotikeve” parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal, gjykata arriti në këto konkluzione juridike:

**Objekti**, i kësaj veprë penale janë veprimet e të pandehurit, që kanë cënuar marrëdhëniet juridike, të cilat janë vendosur për të siguruar dhe garantuar mbarëvajtjen dhe ecurinë normale në veprimtarinë e organeve shtetërore për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike, në respektimin dhe funksionimin e shtetit ligjor, konform rregullave dhe procedurale ligjore përkatëse.

Në mbështetje edhe të akteve ndërkombe, për të siguruar kontrollin mbi prodhimin, importimin, eksportimin, shperndarjen apo përdorimin e drogës lëndëve narkotike apo të substancave psikotrope të mbrojtura posaçërisht nga K. Penal, nga veprimet ose mosveprimet kriminale.

**Nga ana objektive**, kjo vepër penale është është konsumuar nga i pandehuri **Desjan Mingla** me veprime konkludente, duke mbajtur lëndë narkotike kokainë, pesha e pluhurit pa ambalazh është **29.798** gram, lëndes narkotike të llojit kokaine të cilan ligjvënisi e ndalon me ligj të

sanksionuar në kodin penal shqiptar.

**Ana subjektive**, kjo veper penale eshte kryer me faj, veprimi i të pandehurit është kryer me dashje direkte.

Gjykata vlereson se ky element i figures se vepres penale lidhet me qendrimin psikik që mban personi kundrejt veprës së kryer prej tij. Ana subjektive karakterizohet nga dy elemente perberes:

- Faji, pa të cilin nuk mund të ketë pergjegjësi penale;
- kerkon dhe qellimin e posaçëm për të nxjerrë perfitimin material për vete ose persona të tjerë.

**Subjekti i vepres penale**, i kesaj vepre penale, është i pandehuri, pasi ai është i përgjegjshëm dhe mosha e tij në kohen e kryerjes së veprës, është brenda kriterëve ligjore për marrjen në pergjegjesi penale.

Gjykata vlereson se, ne rastin konkret plotësohet ky element, duke pasur parasysh nenin 12 të Kodit Penal, ku thuhet se:

- "Ka pergjegjësi penale personi që në kohën e kryerjes se një krimi ka mbushur moshën katermbedhjetë vjeç. Personi që kryen një kundervajtje penale ka pergjegjesi kur ka mbushur moshën gjashtembdhetë vjeç".

Për sa i përket llojit dhe masës së dënimit për të pandehurin **Desjan Mingla**, Gjykata çmon se, duhen mbajtur parasysh këto rrethana:

- Rrezikshmërinë e veprës penale “Prodhim dhe shitje e narkotikeve” parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal për të cilën ligjvënësi ka parashikuar dënim me **burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet**.
- Rrezikshmerinë e autorit, pasi ka qenë i padënuar më parë.
- Faktin se i pandehuri **Desjan Mingla** ka kërkuar të procedohet me procedurën e gjykimit të shkurtuar.
- Perhapjen e gjere të këtyre veprave penale.
- Gjykata merr parasysh moshën e të pandehurit rreth 30 vjeç.
- Faktin se i pandehuri **Desjan Mingla** është me nivel të ulët arsimore vetëm 9-klasë.
- Gjykata vlerësoi shkallën e rrezikshmërisë së të pandehurit dhe veprës penale, si dhe sa i përket sasisë e lloji i lëndës narkotike të kapur, fakti që është i përdorues i kësaj lënde narkotike.
- Faktin se është hetuar me masë sigurimi personal “Arrest në Burg”.
- Si dhe fakte e rrethana të tjera lehtesuese në mbeshtetje të kerkesave te neneve 48 dhe 49 te Kodit Penal.
- Në kuptim të kerkesave të nenit 50 të K.Penal nuk kerni rrethana renduese në ngarkim të të pandehurit **Desjan Mingla**.

Gjykata vëren se në një vleresim te hollesishem te permbajtjes, konstatimeve si dhe të të gjitha rrethanave të kryerjes së veprës penale nga i pandehuri **Desjan Mingla** Gjykata konkludoi se lloji i dënimit me burgim për të pandehurin i kërkuar nga organi i akuzes mirepritet nga gjykata, pasi ai është në raport te drejte me vleresimin e rrethanave te kryerjes se vepres penale.

Në këto kushte, bazuar në nenet 47-50 të K.Penal Gjykata vëren se, nisur nga rrethanat e mësipërme, i pandehuri **Desjan Mingla** duhet të deklarohet fajtores dhe të dënohet penalisht.



Nisur nga fakti se lloji i dënimit për këtë veprë është me vetëm me burgim, Gjykata çmon se dënimi i të pandehurit **Desjan Mingla** për kryerjen e veprës penale të “Prodhim dhe shitje e narkotikeve” veprë kjo e parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal me **6 (gjashtë)** vjet burgim, në zbatim të nenit 406 të K.Pr.Penale, i ulët 1/3 e masës së dënimit dhe e dënion perfundimisht të pandehurit **Desjan Mingla** me **4 (katër)** vjet burgim, është plotësisht i justifikueshëm dhe në përshatje me rrethanat e kryerjes së veprës penale, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit në rastin konkret.

Të ndodhur përpara këtyre parashtrimeve, percaktimit të faktit dhe provave në gjykim, Gjykata çmon se veprimet e të pandehurit **Desjan Mingla** plotësojnë të gjithë elementet që kërkon legjislacioni penal shqiptar për t’i cilësuar këto veprime si elementë të figurës të parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal.

Po kështu Gjykata çmon të përshatshme për këtë të pandehur aplikimin e nenit 59 të K.Penal.

Gjykata çmon se plotësohen kriteret ligjore për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim të parashikuar në nenin 59 të K.Penal, i cili sanksionon:

*“Për shkak të rrezikshmerisë së pakët të personit, moshës, kushteve shëndetësore apo mendore, menyrës së jetesës apo nevojave, veçanërisht atyre që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, rrethanave të kryerjes së veprës penale si dhe sjelljes pas kryerjes së veprës penale Gjykata kur jep dënimin me burg deri në pesë vjet mund të urdhëroje që i denuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të vihet në provë duke pezulluar ekzekutimin e dënimit me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë veprë tjetër penale”.*

Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe venia në provë e autorit të veprës penale përfshihet në kategorinë e alternativave të dënimit me burgim, që në konceptin e politikës penale synon të zgjerojë mundësitë e edukimit dhe rehabilitimit në shoqëri të personit që ka kryer veprën penale në formë të ndryshme nga ajo e kufizimit të lirisë së tij personave.

Mundësia ligjore e zbatimit të nenit 59 të Kodit Penal kufizohet vetëm brenda kriterëve të parashikuara nga kjo dispozitë, të cilat në thelb lejojnë këtë alternativë dënimi vetëm për shkaqe të posaçme, të lidhura me personalitetin e autorit të veprës penale, moshën e tij, kushtet shëndetësore e mendore, nevojat familjare, ato të punës dhe të shkollimit.

Nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor Gjykata çmon se, pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim, justifikohet duke marrë parasysh personalitetin e të pandehurit, rrezikshmerinë e vogël shoqërore, moshën e tij, menyrën e jetesës si dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale, si dhe qëndrimin e tij pas kryerjes së veprës penale faktin e pranimit të akuzës justifikojnë pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim.

Sa me lart, Gjykata konkludon se në kushtet kur dënimi i caktuar ndaj të pandehurit **Desjan Mingla** është 4(katër) vite burgim nga të cilat 6 (gjashtë) muaj i kryer me masën e sigurimit “arrest në burg”, dhe ekzistojnë disa prej kriterëve të sanksionuara në nenin 59 të Kodit Penal dhe në ndryshimet e fundit me ligjin nr.36/2017 prandaj duhet të urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim të mbetur pa vuajtuar dhe venia në provë e të pandehurit për një periudhë prej **5 (pesë)** vitesh gjatë të ciles ai nuk duhet të kryejë asnjë veprë tjetër penale.

Në zbatim të neneve 59 dhe 61 të K.Penal urdhërohet i pandehuri **Desjan Mingla** të paraqitet rregullisht dhe të informojë në vazhdimësi Shërbimin e Provës për përmbushjen e detyrimeve të mësipërme.

Në zbatim të nenit 60 pika 9 e K.Penal urdhërohet që i pandehuri të mos shoqërohet me

persona të dënuar.

Duke qenë se i pandehuri **Desjan Mingla**, u deklarua fajtor dhe u dënua për veprën penale për të cilën akuzohet, bazuar në nenet 393-485 të K.Pr.Penale, i pandehuri detyrohet të paguajë shpenzimet procedurale të kryera në fazën e hetimeve paraprake, si dhe shpenzimet gjyqësore.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbeshtetur ne nenet 381-384 e 390-406 të K.Pr.Penale Gjykata.

### **V E N D O S I :**

1. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Desjan Mingla** per veprën penale të “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, dhe ne baze te nenit 283/1 te K.Penal denimin e tij me **6 (gjashtë)** vjet burgim.
2. Në zbatim të nenit 406 të K.Pr.Penale i ulet 1/3 e mases se denimit duke e denuar perfundimisht te pandehurin **Desjan Mingla** me **4 (katër)** vjet burgim.
3. Në zbatim të nenit 59 te K.Penal (Ndryshuar me ligjin nr.36/2017) të pezullojë ekzekutimin e denimit me burgim (pjesa e mbetur pa vuajtur) për të pandehurin **Desjan Mingla**, duke e vënë të pandehurin në provë për një afat **5 (pesë)** vjet, me kusht që gjatë kësaj kohe të mos kryejë veprë tjetër penale.
4. Afati i provës fillon nga e nesërmja e shpalljes së këtij vendimi.
5. Ne zbatim të nenit 59 dhe 61 të K.Penal urdhërohet i pandehuri **Desjan Mingla**, të paraqitet rregullisht dhe të informojë në vazhdimësi Shërbimin e Provës Tiranë për përmbushjen e detyrimeve të mësipërme.
6. Në zbatim të nenit 60 pika 9 e K.Penal urdhërohet që i pandehuri të mos shoqërohet me persona të dënuar.
7. Në zbatim të nenit 389 të K.Pr.Penale, shuarjen e masës së sigurimit “arrest në burg”, ndaj shtetasit **Desjan Mingla** dhënë me vendim nr.373 akti, datë 05.03.2021 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
8. Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i të pandehurit **Desjan Mingla** nga dhomat e paraburgimit, në qoftë se nuk mbahet në burg per ndonjë masë apo dënim tjetër.
9. Prova materiale bazuar ne nenin 190, pika 1, germa “b”, te K.Pr.Penale, sekuestruar me proces verbal për sekuestrimin e sendeve datë 02.03.2021, lende e dyshuar si lende narkotike te asgjësohet.
10. **Pranimin** e kërkesës për: Pushimin e hetimeve në ngarkim të miturit në konflikt me ligjin **Daniel Mingla**, për veprën penale të “Prodhim dhe shitje e narkotikëve”, të parashikuar nga neni 283/2 të Kodit Penal, në lidhje me procedimin penal Nr.1612/2021.
11. Ngarkohet prokuroria e Rrethit gjyqësor Tiranë për ekzekutimin e këtij vendimi.
12. Shpenzimet procedurale ne fazen e hetimeve paraprake dhe ato gjyqësore i ngarkohen te pandehurit.
13. Kunder vendimit lejohet ankim ne Gjykatën e Apelit Tirane brenda 15 diteve duke filluar ky afat nga dita e njoftimit të këtij vendimi.

**U shpall në Tiranë, sot më datë 14.07.2021.**

**SEKRETARE**

**GJYQTAR**

**Gentiana  
Ahmet METALIAJ**

**SADIKU**

## **SHPENZIMET GJYQËSORE**

(Sipas neneve 393-485 të K. Pr. Penale)

### **Shpenzime te mases se sigurimit:**

Shpenzime për psikolog: 3.000 (tre mije) leke.

### **Shpenzime proceduriale të hetimit paraprak:**

22.000(njëzet e dymijë)lekë

### **Shpenzime gjyqësore në themel:**

Shpenzime për njoftime 2x150 (njëqindë e pesëdhjetë) lekë=300(treqind)leke

Shpenzime për psikolog: 6.000(gjashtëmije)lekë